



### KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me daten 17/04/ 2001 (dymije e nje) ne zyren e noterise Tirane me adrese Rruga "Puntoret e Rilidjes" para meje Noter HALIL SINANI , u paraqiten personalsiht:

#### SHITESIT :

- 1) Have Bala (Lala), e bija e Asllanit, e dtl. 31.01.1979, lindur ne Kukës e banuese ne Tirane ne Rrugen "Irfan Tomini", p.8/3, shk.2, ap.26.
- 2) Valmira Koldashi (Lala) e bija e Asllanit , e dtl. 18.06.1982, lindur ne Tropoje e banuese ne Tirane.
- 3) Endrit Lala, i biri i Asllanit , i dtl. 29.06.1984, lindur ne B.Curri e banues ne Tirane ne adresen e mesiperme .

**BLERES** : 1) Kadire Lala e dtl. 10.09.1958 , lindur ne Kukës e banuese ne Tirane me adrese Rruga "Irfan Tomini", p.8/3, shk.2, ap.26 ,

Te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si me poshte vijon:

-Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALB SHPRESA " sh.p.k, eshte e regjistruar si person juridik me vendim te gjykates se rrethit Tirane. Nr.2001, date 22.02.1994, me seli ne Tirane, me kapital themeltar 100.000 leke, me ortak te vetem themelues e administrator z. Asllan Lala. Me vendimin e gjykates se rrethit Tirane Nr.932, date 1603.2001 eshte celur deshmia e trashegimise e te ndjerit Asllan Lala. Me vendimin nr. 2001/2, date 09.04.2001 eshte bere depozitimi i vendimit te asamblese se ortakeve nr.2, date 05.04.2001 sipas te cilit kuotat e kapitalit te shoqerise "ALB SHPRSA" u kane kaluar ne rruge trashegimie : 1) Kadire Lala- 25%, 2) Have Bala (Lala)- 25 % , 3) Valmira Koldashi (Lala)- 25 % dhe 4) Endrit Lala -25 %.

-Asambleja e ortakeve me vendimin nr. 3, date 17.04.2001 ka pranuar kerkesen per largimin nga shoqeria te ortakeve : 1) Have Bala (Lala) , 2) Valmira Koadashi e 3) Endrit Lala , te cilet kuotat e kapitalit qe zoterojne ne shoqeri ia shesin ortakut tjeter te shoqerise znj. Kadire Lala , sipas kushteve vijuese te kesaj kontrate:

-Shitesja Have Bala (Lala), zoteruese e 25 % te kuotave te kapitalit te shoqerise , i shet kuotat e kapitalit qe zoteron ne shoqeri ne shumen prej 25.000 (njetzet e pesemije) leke , ndersa bleresja Kadire Lala pranon blerjen e ketyre kuotave .

-Shitesja Valmira Koldashi , zoteruese e 25 % te kuotave te kapitalit te shoqerise, i shet kuotat e kapitalit qe zoteron ne shoqeri ne shumen prej 25.000 (njetzet e pesemije) leke ndersa bleresja Kadire Lala pranon blerjen e ketyre kuotave.

-Shitesi Endrit Lala, zoterues i 25 % te kuotave te kapitalit te shoqerise i shet kuotat e kapitalit qe zoteron ne shoqeri ne shumen prej 25.000 (njetzet e pesemije) leke , ndersa bleresja Kadire Lala pranon blerjen e ketyre kuotave .

-Shitesit Have Bala (Lala), Valmira Koldashi dhe Endrit Lala deklarojne se jane likujduar plotesisht jashte zyres se noterise sipas cmimit te shitjes , leket pasi i kane numuruar i kane gjetur te rregullta.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate konform ligjes , shitesit Have Bala (Lala), Valmira Koldashi dhe Endrit Lala zhvishen nga te drejtat dhe detyrimet qe kane ne kete shoqeri , ndersa bleresja Kadire Lala mbetet ortak e vetme e shoqerise dhe

zoterues e 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise , si dhe fiton te gjitha te drejta dhe detyrimet qe rrjedhin nga ligji.

Kontrata redaktohet ne kater kopje origjinale konform rregullave dhe ligjes. Kjo kontrate bazohet ne dispozitat e nenit 705 e vijues te K.C, neni 46 i ligjit nr.7638, date 19.11.1992 , si dhe statuti i shoqerise.

Paleve te sipershenuara pasi iu lexua kjo kontrate, iu spjegua permbajtja e saj , me vullnetin e tyre te lire e nenshkruajne rregullisht para meje. Meqenese ortaku Endrit Lala nuk ka fituar zotesine e plote juridike per te vepruar, ne vend te tij nenshkruan e nena e tij Kadire Lala ne pranine e shitesave te tjere .

Une noter e vertetoj sipas ligjit.



### P A L E T

#### SHITESIT

1) Have BALA (LALA)

#### BLERESI

1) Kadire LALA

2) Valmira KOLDASHI (LALA)

3) Endrit LALA

NOTER  
HALIL SINANI